



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:070553

Datë: 24.07.2019

Numri i dokumentit: 00401712

PKR. nr. 68/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtari Gëzim Pozhegu, kryetari i trupit gjykues, gjyqtarët Myfera Hoxha dhe Shaqir Zika, anëtar të trupit gjykues me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arbënore Basha, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.B., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3, lidhur me par. 1. nënpar.1.1. të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I.nr.80/2018 të datës 17.12.2018 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datat 17.04.2019, 02.05.2019, në prezencën e prokurorit Ramiz Buzhala, të dëmtuarit A.A., të akuzuarit A.B. dhe mbrojtësit të tij A.M. avokat në Gjakovë, me datë 06.05.2019, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 24.07.2019, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A.B.**, i biri i S. dhe nënës S., e gjinisë B., data e lindjes..., në Gjakovë, numer personal..., ka të kryer shkollën e mesme-Gjimnazin, i papunë, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i padënuar më parë.

Është Fajtor

Sepse:

Me datë 15.09.2018 rreth orës 02:30 minuta ne fshatin D., Komuna Gjakovës, pikërisht në oborrin e objektit fetar “T. e Z.D.D.” (T. e babës D.) i shkakton lëndime të rënda trupore personit tjetër, këtu të dëmtuarit A.A., në atë mënyrë që pasi i dëmtuari ishte vërejtur duke vjedhur, duke tentuar ta arrestojnë i dëmtuari duke rezistuar tenton ta sulmon me kaçavidë (shafsiger) personin A.Rr., i pandehuri pasi i ofrohet e sulmon duke e goditur me lopatë-mjetë të rrezikshëm një herë në kokë në pjesën e pasme ku si pasojë e goditjes i dëmtuari rrëzohet në tokë, me ç’rast i shkakton lëndime të thyerjes së kockës së tepës së kokës majtas, me zhvendosje të fragmentit kockor të cilat janë lëndime të rënda trupore.

- **Me çka ka kryer veprën penale: lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3, lidhur me par. 1. nënpar.1.1. të KPK-së.**
-

Andaj, **Gjykata** në kuptim të nenit **3, 6, 17, 21, 38, 42, 44, 69,70, 186** par.3 lidhur me par **1.** nënpar.1.1. të i KPRK-së si dhe neneve **359** paragraf **2, 365, 366,368, 450, 463** të KPPK-së, të akuzuarin A.B.e

GJYKON

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me kërkesën e të akuzuarit e bazuar në nenin 44 të KPRK-së, zëvendësohet me **dënim me gjobë** në shumën prej **3.000,00 € (tremijë euro)**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afatin prej 1 (një) muaj nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, i njëjti do ta vuaj dënimin e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve**.

Në Kuptim të nenit 450 par.4 të KPPK-së, i akuzuari obligohet që të paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej njëzetepesë (25) €, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzetepesë (25) € si dhe shumë prej pesëdhjetë (50) € në emër të kompensimit të viktimave të krimit, konform neni 39 par.3, nënpar.3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e cila shumë duhet paguar në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Konfiskohet lopata si objekt i kryerjes së veprës penale, e cila pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit do të shkatërrohet.

Duke u bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së, pala e dëmtuar udhëzohet që kërkesën pasurore juridike të realizoi në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me aktakuzën PP/I.nr.80/2018 të datës 17.12.2018 ka akuzuar A.B., për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3, lidhur me par. 1. nënpar.1.1. të KPRK-së.

Në seancën fillestare të mbajtur në Gjykatën Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, me datën 01.02.2019, i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë.

I akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancën e mbajtur me datë 17.04.2019, para trupit gjykues, është deklaruar i pafajshëm, ku pas kësaj, kryetari i trupit gjykues ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor në të cilën shqyrtim ka vendosur lidhur me kërkesën penalo-juridike të prokurorit të shtetit me përmbajtje si në aktakuzën e parashtruar.

Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala në shqyrtimin gjyqësor ka bërë rikualifikimin e veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1., nënpar.1.1 të KPRK-së, “në veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3, lidhur me par. 1. nënpar.1.1. të KPRK-së” konform dispozitës së nenit 3 të Kodit Penal të Kosovës si ligj më i favorshëm për të pandehurin.

Në fjalën hyrëse prokurori i shtetit ka deklaruar : Me aktakuzën PP/I.nr.80/2018 datë 17.12.2018 i pandehuri A.B. ngarkohet për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3. lidhur me par.1. nënpar.1.1. të KPRK-së të kryer siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës. Pretendimet e akuzës do të vërtetohen gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor me provat që do të parashtrihen para gjykatës, siç është dëgjimi i këtu të dëmtuarit A.A., i cili para gjykatës do të vërteton faktin se, ku është hasur si dhe me çka është sulmuar nga këtu i pandehuri A. Dëgjimi i dëshmitarëve A.Rr. dhe U.R. të cilët edhe njëherë para gjykatës nuk do ta mohojnë faktin se i pandehuri me mjetë të fort-lopatë e ka sulmuar këtu të dëmtuarin A.A., i cili natën kritike është hasur duke vjedhur në oborrin e Tyrbes, gjithashtu provat materiale siç është raporti i ekspertit mjeko ligjor B.C., sipas të cilit si pasojë e goditjes i dëmtuari ka pësuar lëndime të rënda trupore, pastaj CD –ja e marrë nga vendi i ngjarjes ku shihet në mënyrë shumë të kurtë se si është sulmuar këtu i dëmtuari. Të gjitha këto prova pasi të administrohen nga gjykata do të vërtetojnë në tërësi pretendimet e akuzës të dhëna në dispozitivin e saj.

I dëmtuari A.A. në fjalën hyrëse deklaron : se mbështesë në tërësi fjalën hyrëse të prokurorit të shtetit.

Në fjalën hyrëse mbrojtësi të akuzuarit A.B.av. A.M., ka deklaruar: Paraprakisht mbesë pranë parashtrimeve në kundërshtimin e aktakuzës së dorëzuar në gjykatë, edhe pse kërkesa jone është refuzuar, provat të cilat i propozojë përfaqësuesi i akuzës poqë se nxjerrën do të dëshmojnë se natën kritike paraprakisht këtu tani i dëmtuari A.A. ka sulmuar dhe rrezikuar jetën e të ashtë quajturit A.Rr., i cili në rastin konkret sipas aktakuzës është propozuar që të dëgjohet vetëm në cilësinë e dëshmitarit, e këtë pa dashur që ta paragjykojë apo gjykojë çështjen në rastin konkret sikur të mos ishte sulmuar A.Rr., tani A.B. nuk do ta kishte goditur të dëmtuarin A.A., këtë për faktin se i akuzuari A. vetëm ka ndërmarrë veprime në shqetësim, duke pa situatën për ta parandaluar që mos të bëhet më e keqja ndaj shokut të tij të cilin e ka goditur, këtu i mbrojturi im të dëmtuarin në vetëmbrojtje e ka goditur. Pafajësia e tij do të vërtetohet me dëgjimin e dëshmitarit A.Rr. sipas nevojës edhe dëshmitarit U.R. i cili nuk është prezentë, po ashtu shqimi i CD-ve të cilat i ka prezantuar prokurori i çështjes.

Në fjalën hyrëse i akuzuari A.B. ka deklaruar se e mbështetë në tërësi fjalën hyrëse të mbrojtësit të tij dhe nuk ka tjetër çka të shtojë.

FJALA PËRFUNDIMTARE

Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala në fjalën e tij përfundimtare deklaron se :

Me zbatimin e provave gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor aktakuza ka treguar se këtu i akuzuari A.B. ka kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 lidhur me par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës. Gjendja e këtyre faktike u vërtetua nga provat që u proceduan gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, siç ishte dëgjimi i këtu të dëmtuarit A.A. në cilësinë e dëshmitarit, i cili në dëshminë e tij ka vërtetuar se pasi që hasur në oborrin e Tyrbes, në qoshin e prapmë në drejtim të R. së K. në pjesën veriore të Tyrbes, nga këtu i pandehuri dhe shokët e tij, nga i njëjti është goditur me lopatë dhe pas kësaj ka humbur vetëdijën dhe nuk i kujtohet asgjë deri në SR “I.G.” në Gjakovë.

Gjithashtu edhe dëshmitarët A.Rr. dhe U.R. në dëshmitë e tyre para gjykatës nuk e kanë mohuar faktin se këtu i pandehuri, pasi e kanë hasur të dëmtuarin duke tentuar të vjedh në

oborrin e tyrbes, nga i njëjti është goditur me lopatë në pjesën e prapme të kokës, edhe pse pretendojnë se të njëjtin veprim i pandehuri e ka ndërmarrë duke tentuar që ta zbraps sulmin që i dëmtuari ka ndërmarr në drejtim të shokut të tij A.Rr.. Nga provat materiale të procedura gjatë këtij shqyrtim i gjyqësor raporti i oficerit policor K.K. nr. PK 09938 datë 15.09.2018, raporti i oficerit policor V.G. me nr. PK ..., datë 15.09.2018, raporti i oficerit policor B.K. me nr. PK ..., datë 15.09.2018, coopora deliktit (lopatës).

Gjithashtu nga ekspertiza mjeko-ligjore e Dr.B.C. datë 30.10.2018 e konstatohet se të dëmtuarit janë shkaktuar lëndime të rënda trupore, si pasojë e veprimit të mjetit të fortë mekanik të topitur. Andaj për arsyet e lartcekura konsiderojë se në veprimet e të pandehurit formohet të gjitha elementet e veprës penale me të cilën ngarkohet me aktakuzë, ashtu që i propozojë gjykatës që pas administrimit të provave të lartcekura të njëjtin ta shpalli fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit, duke i propozuar gjykatës që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese sipas dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, ashtu që të njëjtit ti caktohet lloji dhe lartësia e dënimit i cili është në proporcion me peshën e veprës penale, përgjegjësinë penalo-juridike si dhe i cili dënim do të ndikojë në të ardhmen mos të kryej vepra tjera penale respektivisht të mos përsërisë vepra penale të natyrës së njëjtë.

I dëmtuari A.A. ja deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit.

Mbrojtësi i të akuzuarit avokati A.M. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se:

Mbes në tërësi pranë parashtrimeve në kuptim të mbrojtjes të parashtruara gjer më tani, dhe shtojë nga provat e administruara, me dëgjimin e dëshmitarëve, shikimin në video incizim CD-në të datës 15.09.2018, rezulton se këtu i akuzuari në atë kohë në orën 02.30/h e tutje paraprakisht ka qenë në gjumë dhe është zgjuar nga gjumi, nga personi i tretë, se dikush është duke e thyer apo vjedhur tyrben, i njëjti është qu nga gjumi shumë shpejtë dhe prë gjykatën, prokurorin e të gjithë të tjerët është e kuptueshme gjendja emocionale kur dikush zgjohet nga gjumi, akoma pa u ngi gjumë, cili është reagimi dhe gjendja psikike e atij personi, i njëjti nga shqetësimi i madh dhe situata emocionale që iu është krijuar në atë moment, nga dhoma e fjetjes në Teqe, duke i veshur rrobat, ka vrapuar në drejtim të Tyrbes me qëllim që mundësisht të nxihet personi i dyshimit, i cili ishte duke e vjedhur tyrben, se kesi soji kishte marrë informatën nga i ashtuquajturit M.B. dhe B.M., pastaj në moment ka vërejtur se personi i dyshimtë është kacafytur me A.Rr. shoku i tij, i cili disa sekonda më parë kishte arritur në vendin e ngjarjes, por A. ishte duke u tërhequr nga ana e pasme ndërsa personin e dyshimtë e ka pa duke e sulmuar A., me mjet të përshtatshëm dhe pasi që personi i dyshimtë e goditi A. një herë, por tenton prapë që ta godas, e cila shihet shumë kuartë në video incizim, për momentin pa e ditur pasojnë apo shkallën e pasojës me lopatë të cilën rrugës e kishte marrë si mjet vetëm për mbrojtje e godet personin e dyshimtë, i cili në këtë procedurë tani na paraqitet si i dëmtuar.

Pavarësisht pas goditjes, i cili është goditur vetëm një herë menjëherë ka lajmëruar Stacionin e policisë në Gjakovë dhe kanë kërkuar ndihmën e shpejtë, që t'ia japin personit të dyshuar i cili ishte lënduar, të gjitha këto veprime i ka bërë nga shqetësimi i madh emocionale dhe frika e asaj nate, mirëpo të nesërmen ka kuptuar se nga goditja që ka pësuar A. atë natë, A. ka qenë i lënduar në pjesën e majtë, nën shpatull të kraharrorit, e cila dëshmohet me foto dokumentacion pavarësisht fakteve se këto prova nuk janë nxjerrë nga policia, këto janë dëshmi materiale të besueshme, për faktin se personat në fjalë të cilët u proceduan si dëshmitarë janë besimtarë, të cilët pranë gjykatës kanë folur vetëm të vërtetën, nuk kanë nevojë që ti shmangen realitetit.

Nga e tërë kjo që u tha më lartë i propozojë gjykatës që të akuzuarin ta lirojë nga aktakuza, meqenëse veprimet e tija janë në proporcion me pasojat që kanë mundur ti shkaktohen A.Rr. në atë kohë pas mesnate duke u zgjuar nga gjumi befas, po qe se Gjykata nuk bënë rikualifikimin sipas detyrës zyrtare e që në rastin konkret të gjitha elementet e veprimeve mund të jenë nga neni 186 par.1. të KPRK-së, po qe se gjykata konstaton se te i akuzuari ka elemente të veprës penale në veprimet e tij, ti shqiptojë një dënim sa më të butë, duke marrë për bazë rrethanat e lartcekura, të cilat veprime i ka ndërmarrë pa dashje që ti shkaktojë të dëmtuarit ato lëndime, por veprimi ishte vetëm preventivë, por në pamundësi që të vlerësojë pasojnë, prandaj duke marrë për bazë se i akuzuari nuk është i gjykuar më parë, jo për vepër penale, por as për kundërvajtje, duke marrë parasysh sjelljen e tij gjatë gjykimit, korrektësisë, se i njëjti është i vetmi ushqyes i familjes 6 anëtarësh, gjendjen e tij ekonomike familjare dhe deklarin e tij se në kushte normale nuk do ta ndërmernte një veprim të tillë, këtë situatë gjykata në mungesë të shprehjes t'ia vlerësojë si pendim.

I akuzuari A.B. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, njëherit shton se më vie keq që ka ndodhur rasti, qëllimi im ka qenë parandalimi e jo.

MBROJTJA E TË AKUZUARIT

Pasi njoftohet për të drejtat e tij, i akuzuari ka deklaruar se do të mbrohet me deklarin, njëherit në pyetjet e parashtruara nga mbrojtësi i tij av. A.M.i njëjti ka deklaruar :

Me datën 15.09.2018 kam qenë në T. e Sh.Z.A.D.D. në fshatin D. nje, pas mesnatës për afërsisht kemi qenë rreth 30 vetëve, në dhomën ku kam qenë duke fjetur unë kanë qenë 10-15 besimtar, në ato momente ka ardhur M.B. ka lajmëruar se një hajnë është në Tyrbe dhe jemi qu me vrull 3-4 veta të cilët kanë ndëgjuar, kemi zhdryu poshtë, B. i me A. kanë qenë përpara nesh, ata janë sjellur nga pjesa e prapme e tyrbes dhe janë dal mbrapa, aty janë takuar me hajnin, edhe na në pjesën tjetër pak mas tyre, jemi dal mbas tyrbes, në ato momente, A.R. ka qenë duke ikur prej konfliktit me hejnin që normalisht në bazë të zhurmave dhe fjalëve që kam ndi, e ka sulmuara garantë, se mi pa nuk e kom pa, se nuk kam qenë në atë pjesë, edhe prej frikës se hajni mundet me e dëmtuar Rr., me pas fatalitet shoku im, se e kom pa që hajni i ka pasur mjetë të metaltë në dorë, e kom goditur vetëm njëherë të dëmtuarin, për me e parandaluar sulmin e tij ndaj shokut tim. Kjo ka qenë në pika të shkurta.

Kur kam shkuar aty e kam ndëgjuar Rr. duke kërkuar ndihmë. Pjesa e pasme e Tyrbes, është rruga e fshatit e cila të qonë në fshatin D. e jo rruga kryesore (asfaltuar).

Në momentin kur na ka thirr dikush, unë kam qenë në dhomë në gjumë.

Tyrbja e B.R. ka qenë e thyer 1 herë, ndërsa e B.D. 3 herë, për mi parandaluar vjedhjet, fshati kemi mbledhur mjetet dhe i kemi vendosur hekurat nëpër dritare.

Personin (i dëmtuari) pasi ka ra në tokë po, emrin mbiemrin jo faktikisht, por si figurë po e kom njohur, sepse kur është thyer herën e parë tyrbja kemi vendosur kamera, mandej kur e ka thyer personi herën e dytë, shihet kjartë kush e ka thyer, dhe janë video incizimet.

Çdo herë i kemi njoftuar organet, i kanë parë edhe videot.

Pasi që e ka goditur A., e kom goditur unë personin (të dëmtuarin), i cili ka qenë me shpinë nga unë, afër shumë ka qenë 30-40 cm, mbas meje ka qenë U.. Ndërsa A. ka qenë përballë me personin e dyshimtë.

A. ka qenë ballë për ballë me të dëmtuarin, ku i dëmtuari ka qenë duke e sulmuar A. me një mjet metalik në dorë, çka ka qenë nuk di.

Të nesërmen e kom pa se A. ka qenë i goditur në anën e majtë ndër dorë.

Atë natë kemi thirr ndihmën e parë dhe policinë.

Personin e dyshimtë e kom qëlluar me qëllim me e mbrojtur shokun tim.

Në pyetjet e Prokurorit të shtetit drejtuar të akuzuarit, i akuzuari A.B.ka deklaruar se:

Në vendin e ngjarjes, kanë qenë B.M., A.Rr., Unë dhe U.R..

Largësia prej vendit ku kemi qenë duke fjetur deri në vendin ku është hasur i dëmtuari ka qenë 30 deri në 35 metra. B. me A. kanë qenë pak përpara nesh, ndërsa unë me U. mbas tyre .

Kur kemi shkuar në vendin e ngjarjes kemi pa të dëmtuarin duke e sulmuar A., A. ka qenë duke u tërhekur prej trupit të dëmtuarit, i dëmtuari ka pasur diçka metalike në dorë, unë e kam goditur për me e parandaluar sulmin ndaj shokut tim.

Po në vendin ku ka ndodhur rasti ka pas ndriçim, ka drita, në aksham dhezen në sabah ndalen.

Nuk e kom pa më B.M.

Të dëmtuarin e kam goditur me lopat(kaci).Pasi që e kam pa të rrëzuar për tokë, i kom pa gjakun, e kom pa se e kisha goditur në kokë, përpara nuk e kom ditë se ku e kam qëlluar.

Të dëmtuarin jo nuk e kom goditur mo, tentim më doket se e kom pas edhe një tentim apo mi ra nuk i kom ra.

Po, të tjetër kanë tentuar me më ndal, se nuk kom ditë për veti.

Lopatën me të cilën e kom goditur të dëmtuarin e kom marrë në skaj të derës së oborrit të tyrbes, e cila ka qenë larg 15 metra nga vendi i ngjarjes, pasi që gjatë ditës ishim duke punuar, duke shtruar rrugën e oborrit me zalle.Për U. e di që nuk ka pasur asgjë në dorë, për A. dhe Blerimin nuk i kom vërejtur që kanë pasur diçka në dorë.

Kur është qëlluar i dëmtuari të gjithë shokët që i përmenda kanë qenë afër meje.

Të nesërmen jam njoftuar për lëndimin e A.

Kur kemi dal prej dhomës së gjumit qëllimi jonë ka qenë ta kapim të dyshuarin dhe ta lajmërojmë policinë.

Nashta edhe kemi mujt me e kap të dëmtuarin pa e goditur, ndoshta kish mujt me ik, nuk di çka me thënë.

Në pyetjen e ATGJ Sh.Z.: Deklaruar se tyrbja është thyer 3 herë dhe ka pasur kamera të vendosura, a keni mujt me identifikuar kryesin e kësaj vepre?

I akuzuar përgjigjet.: Po në bazë të kamerave herën e dytë kur është thyer tyrbja shihet fytyra e të dyshuarit.

Kemi tentuar përmes tezakut të tij, i njëjti ka shkuar me fol me ta, familja e tij kanë thënë se na vjen keq për rastin që ka ndodhur ishalla nuk ju shqetëson kush herën tjetër.

Gjykata mbrojtjes së të akuzuarit A.B. ia fal besimin pasi që edhe në bazë të dëshmive të dëshmitarëve u vërtetua se këtu i akuzuari ka vepruar siç ka deklaruar edhe më lart.

Gjykata pas administrimit dhe vlerësimit të provave të administruara një nga një në lidhmëni me provat tjera në kuptim të nenit 361 të KPPK-së, ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon :

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha provave një nga një, e pastaj të ndërlidhura me njëra tjetrën ka vërtetuar se i akuzuari A.B. ka kryer veprën penale të lëndimit të rëndë trupor nga neni 186 par. 3 të KPRK-së.

Këtë gjendje të fakteve gjykata e ka vërtetuar në bazë të dëshmive të: dëmtuari-dëshmitari A.A., dëshmitarëve A.Rr. dhe U.R., nga raporti i oficerit policor K.K.nr. PK..., datë 15.09.2018, raporti i oficerit policor V.G.me nr. PK..., datë 15.09.2018, raporti i oficerit policor B.K. me nr. PK ..., datë 15.09.2018, nga corpora deliktit (lopatës), nga shikimi i CD-së nga vendi i ngjarjes, ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. B.C. datë 30.10.2018 e protokolluar në prokurori me datë 01.11.2018 si dhe nga foto dokumentacionit.

Analiza e provave të administruara

Dëshmia e dëshmitarit –dëmtuari A.A. nga Komuna e Kukësit, R. e Shqipërisë.

Në dëshminë e tij ka deklaruar:

Se me datën 15.09.2018 rreth orës 02:30/h, kam qenë në fshatin D., saktësisht kam qenë tek ana e mbrame e tyrbes, në oborr të tyrbes së B.D., si jam kthyer me fytyrë nga rruga më ka dal njëri përpara dhe tjetri nga prapa më ka goditur, nuk më kujtohet ku më ka goditur.

Qëllimi i im që kam shkuar në tyrbe, ka qenë për me bo nezër për qiken se kam pas me e qu të nesërmen në spital.

Kur jam takuar me të pandehurin dhe dëshmitarët tjerë në dorë kom pasur vetëm letrat e spitalit të vendosura në këse, për qikën që kam pas mi qu në spital në Tiranë.

Para se me më sulmuar, nuk kam sulmuar askënd.

Kur jam takuar me të pandehurin, kam qenë në oborin e tyrbes, në qoshin e prapmë në drejtim të R. së k.(pjesës veriore).

Kur jam zatetur me ta në oborin e tyrbes e kom pa një person, i cili më ka dal para, tjetër nuk kom pa. Nuk e di sa ka qenë larg meje personi që më ka dal përpara. Nuk më kujtohet kur më është kthyer vetëdija.

Së pari më kanë dërguar në spital në Gjakovë , ku kam qëndruar 2 orë, nga aty më kanë dërguar në spital në Prishtinë ku kam qëndruar 11 ditë.

Gjendja ime shëndetësore është se kam probleme, nuk më duron as të ftoftin e as diellin.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.B., av. A.M.i parashtron pyetje dëshmitarit.

Para se të vjen tek Tyrbja e B.D. ku ka ndodhur aksidenti, ku ke qenë orë më parë?

Dëshmitari përgjigjet. : Kam ardhur prej Shqipërisë, nuk më kujtohet saktë se kur e kam kaluar kufirin, nuk e kom shikuar sahatin asnjëherë, jam legjitimuar nga pika kufitare e Kosovës, atë natë për në Kosovë kam udhëtuar me kombi. Nuk më kujtohet se me cilin taksi kam udhëtuar. Taksi ka qenë me targa të Kosovës.

Po e di se ku është është tyrbja e Sh.R, pasi që kam qenë dhëndër i B. në fshatin B. i B.. Në tyrbe kam hyrë ka dera kryesore. Me vete nuk kam pasur gjëra të forta.

Unë nuk kam dijeni as që kam dëgjuar se dikush ka bërtitur apo ka thënë Hajnat.

Nuk më kujtohet, se me çka e kam sulmuar personin që e kam pasur përpara

Po jam besimtar i fesë muslimane.

Nuk e kam ditur dijeni se sipas Kuranit të Shenjtë nuk është e preferuar që në mbrëmje pasi të falet akshami, nuk preferohet që të lutesh për ndihmës në vende të shenjta dhe të hyhet në hapësirën ku ka varreza.

Në pyetjen: Thatë më parë se keni qenë në pjesën e pasme, pjesa e pasme nuk është nga dera kryesore?, dëshmitari nuk përgjigjet.

Nuk e njoh personin që më ka ra

Në pyetjen e Av.A.: A ki diçka kundër personit që të ka ra?
Dëshmitari përgjigjet.:Nëse nuk e ndjek ligji, e ndjeki privatisht.

Në pyetjen e KTGJ.: A i bashkëngjitësh ndjekjes penale dhe a kërkon kompensim të dëmit material?

Dëshmitari përgjigjet: I bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe kërkojë kompensim të dëmit material.

Në pyetjen e të akuzuarit .: A të kujtohet që e ke sulmuar një person ?

Dëshmitari përgjigjet: E di një person kur më ka dal para e kam shtyrë me duar në gjoksin e tij.

Nuk e kom ditë se a është e zakonshme dhe sa ka qenë ora , por kam shkuar se kam pas me e qu qikën në vizitë në spital në Tiranë.

Po kam qenë edhe më herët në Tyrben e B.D. dhe kam qenë edhe në Tyrbe P.

Qëllimi im pse kam shtyer personin ka qenë për mos me bo fjalë, për mos me u ngatërru.

Gjykata deklaratës së të dëmtuarit-dëshmitarit A.A. pjesërisht ia fal besimin;

Kur këtu i dëmtuar-dëshmitari deklaron se ka shkuar në orën 02:30/h në tyrbe dhe se derisa qëndronte afër tyrbes kanë ardhur personat të cilët ishin në objektet përcjellëse të tyrbes dhe njëri e ka sulmuar nga ana e përparme, kurse personi tjetër e ka sulmuar nga pas dhe e ka goditur në kokë dhe në atë moment ka humbur vetëdijen.

Gjykata nuk ia fal besimin kur thotë se në tyrbe ka shkuar me qëllim për të qit nezra, pasi që e ka pasur vajzën e sëmur dhe ka pas me e dërgu në spital në Tiranë, meqenëse kur ka shkuar në tyrbe ka qenë ora 02:30/h pas mesnatës, gjë që është e jashtëzakonshme nga besimtarët që të shkohet në këtë kohë në tyrbe.

Gjykata duke u bazuar në deklaratat e mësipërme të të dëmtuarit-dëshmitarit ka ardhur në përfundim se i njëjti në tyrbe ka shkuar me qëllim të vjedhjes së parave në tyrbe, këtë e ka vërtetuar edhe nga Aktgjykimit P.nr.825/18 datës 04.12.2018, në bazë të cilit aktgjykim i njëjti është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti për vepër penale nga neni 327 par.2 nënpar.2.2. lidhur me par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, e me çka konstatohet se qëllimi i të njëjtit ka qenë vjedhja në këtë tempull e jo qitja e nezrave.

Dëshmitari A.Rr.

Dëshmitari A.Rr. nga Gjakova, në dëshminë e tij të dhënë në gjykatë me datë 17.04.2019 ka deklaruar :

Se me datën 15.09.2018 pas mesnatës kam qenë në fshatin D. në objektin fetar të Teqes së Sh. D.D., atë natë me mua kanë qenë A.B., U.R., H.B. etj, jeni tubuar atë natë aty pasi ka qenë muaji Muharrem, gjatë 10 ditëve të para të muajit Muharrem buajim në Teqe.

Rreth orës 02:30/h të mëngjesit ka ardhur një besimtar i Teqes tonë M.B. dhe na ka njoftuar se dikush është duke e thyer Tyrben e B.D., atë moment jemi ngritur dhe jemi dal jashtë, unë kam qenë i pari që kam shkuar në rast, për qëllim për mi ndaluar se i njëjti person e ka thyer edhe 2

herë përpara e ka thyer Tyrben, kur jemi dal jashtë atë natë me mua ka qenë B.M. dhe askush tjetër.

Në pyetjen e prokurorit.: Kur keni dal jashtë çka keni vërejtur?

Dëshmitari përgjigjet : Kemi vërejtur se për momentin nuk ka qenë te dera e Tyrbes, por pastaj jemi dal nga mbrapa Tyrbes dhe e kemi parë , te e njëjta dritare, kur e ka thyer edhe 2 herë tjera tyrben dhe në atë moment kemi pasur shkëmbim të piskamës në mes veti, dhe qëllimi im ka qenë me shku me e kap personin dhe me e lajmëruar policinë, dhe në atë moment personi A.A. është ulur në tokë dhe ka kapur shafsigerin (kaqavidën) dhe më ka goditur njëherë në anën e majtë të barkut, për çka kam edhe fotografimin, nuk kam qenë te mjeku, sepse atë natë nuk kom pasur dhimët dhe e jemja ka qenë se veç a jam mirë, të nesërmen kam pasur dhimë dhe e kom pa vendin e mavijosur, tek mjeku nuk kam shkuar.

Pastaj i njëjti ka tentuar me më goditur prapë me shafsiger por unë jam larguar dhe nuk më ka goditur, dhe pastaj unë jam tërhekur, duke u tërhekur ka ardhur A.B., po të mos kishte qenë ky, nuk do të dihej për fatin tim se ku do të isha.

Kur ka ardhur A. e ka goditur me lopatë.

A. ka qenë larg prej kur ka ardhur A.B. distancë e vogël më së shumti 50 cm deri në 1 metër. A. ka ardhur nga ana e pasme. A. nuk ka folur asgjë para se mi ra të dëmtuarit. Pasi i ka ra A. të dëmtuarit, i dëmtuari ka ra në tokë, nuk e di se në cilën pjesë të trupit i ka ra.

Në momentin kur më kanë thirr kam qenë në Teqe, në dhomë duke pushuar, ku kemi qenë 10 veta afërsisht.

Kur kam mbri i pari tek Tyrbja, kam kërkuar ndihmë ku së pari jam goditur prej personit të panjohur, kam kërkuar ndihmë duke bërë titur : B. ndihmë, i cili ishte me mua së bashku.

A. ka ardhur nga pjesa e pasme e këtu të dëmtuarit dhe i ka ra me lopatë, mbasi i ka ra të dëmtuarit e kom pa lopatën në duar të A..

Kur është ulur këtu i dëmtuari, kur më ka pa mua aty, në tokë, përveç kaqavidës, ka pasur edhe pajser (shufër metalike).

Po në çoshe ka pas dritë sijalicë.

Gjykata deklaratës së të dëshmitarit A.Rr. pjesërisht ia fal besimin;

Ku deklaron se me datën 15.09.2018 pas mesnatës kanë qenë në fshatin D. në objektin fetar të T.së Sh.D.D., me te atë natë kanë qenë A.B., U.R., H.B. etj, ku janë tubuar aty pasi ka qenë muaji Muharrem, gjatë 10 ditëve të para të muajit Muharrem buajim(flejim) në Teqe.

Rreth orës 02:30/h të mëngjesit ka ardhur një besimtar i Teqes tonë M.B. dhe na ka njoftuar se dikush është duke e thyer Tyrben e B.D., atë moment jemi ngritur dhe jemi dal jashtë, unë kam qenë i pari që kam shkuar në rast, për qëllim për mi ndaluar pasi edhe dy herë më parë përpara e kanë thyer Tyrben.

Gjykata nuk ia fal besimin kur dëshmitari deklaron se me rastin e takimit gjegjësisht ballafaqimit e këtu të dëmtuarin A.A. ka marrë lëndime trupore duke e shpuar me kaqavidë në anën e majtë të gjoksit, nën dorën e majtë, për arsye lidhur me këtë lëndim i njëjti nuk ka shkuar për shërim, as nuk ka raport mjekësor meqenëse siç deklaron edhe vet lidhur me këtë lëndim nuk ka shkuar te mjeku, por e ka dokumentuar me foton e fotografuar një ditë para mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor 17.04.2019, siç u deklarua mbrojtësi i të akuzuarit A.B., avokati A.M., që donë të thotë se i njëjti këtë foto e ka bërë pas 7 muajve nga dita kritike dhe

në foto nuk shihet se a është shpuarje por një grithje që nuk është si pasojë e lëndimit me kaqavidë.

Dëshmitari U.R.

Pasi që dëshmitari njoftohet me të drejtat e tij dhe jep betimin , i njëjti në dëshminë e tij ka deklaruar :

Me datën 15.09.2018 , pas mesnatës kam qenë në Teqen e Sh.Z.A.D.D. në fshatin D., kam qenë në dhomë. Në Teqe kemi shkuar për shkak se ka qenë muaji i shenjtë i Muharremi, pos meje në Teqe atë natë kanë qenë diku rreth 15 besimtarë në dhomë, në mesin e tyre a ka qenë edhe A.(i akuzuari).

Unë kam qenë në dhomë duke fjetur me të gjithë besimtarët tjerë, në atë moment ka hyrë në dhomë besimtarë M.B., dhe na ka zgjuar prej gjumit, duke na thënë : Se hajdi zgjohi se një person është në Tyrbe duke tentuar me vjedhur! ato momente unë jam qu shpejt dhe jam veshur dhe kam dal shpejt poshtë, kur kam dal poshtë në oborr e kom pa A. dhe B., në ato momente kam dëgjuar zëra të A.Rr. duke kërkuar ndihmë dhe kam vazhduar në oborr të Tyrbes, ato momente A. ka qenë duke e mbrojtur veten nga këtu i dëmtuari, në ato momente kemi vrapuar Unë dhe A., dhe e kemi pa A. duke e mbrojtur vetën i cili ka qenë larg nga i dëmtuari 1 metër, pasi që i dëmtuari në dorë kishte shafsiger dhe një hekur të madh dhe A. i ka ra të dëmtuarit me kaci, vetëm një herë.

Kur jemi shku në vendin e ngjarjes A. dhe i dëmtuari kanë qenë afër duke u rrokur, nuk ka pas largësi me metër ose milimetër. kur i keni pa duke u rrokur na kemi dal nga ana e mbrapme. Pasi që i ka ra me kaci, i dëmtuari ka rënë në tokë, mo nuk ka tentuar me i ra askush të dëmtuarit dhe të nesërmen kur kemi dal mi pastru gjakun, e kemi gjetur një thikë.

Në pyetjen e KTGJ.: A ka pasur në dorë i dëmtuari thikën atë natë?

Dëshmitari përgjigjet.: Jo, E vërteta është që e kemi gjete thikën të nesërmen. Kur kam shkuar në vendin e ngjarjes natën kritike, nuk e kom pa duke i ra i dëmtuari A., por i ka ra në krah në dorë, në cilën anën nuk më kujtohet.

KTGJ.: Në cilin vend i ka ra i dëmtuari A.?

Dësh.: Në gjyks i ka ra, në pjesën e poshtme.

Në vendin e ngjarjes nuk kem gjetur diçka tjetër.

Kur jam shku nga Teqja në oborrin e tyrbes, kom dëgjuar A. duke thirr ndihmë.

Në pyetjen e ATGJ.Sh.Z.: A ka tentuar me hap derën?

Dëshmitari përgjigjet. : Jo atë natë nuk e kam parë.

Në pyetjen e ATGJ.Sh.Z.: Të nesërmen a ke vërejtur gjurmët dhe në cilin vend ka pasur gjurmë?

Dëshmitari përgjigjet.: Në dritaren e tyrbes ka pasur gjurmë, hekurat e dritares kanë qenë të shtrembëruar.

KTGJ.: Përshkruaje se çfarë kanë qenë hekrat e vendosur në dritare të tyrbes?

Dësh.: Hekrat kanë qenë në formë katrore.

KTGJ thërret dëshmitarin A.Rr. dhe atij i parashtron pyetje, lidhur me provën të cilën e prezantojë mbrojtësi i të akuzuarit A.B., av. A.M..

Dëshmitari A.Rr. deklaron : se unë jam lënduar me kaqavid (shqfciger) në anën e majtë të trupit, nën dorë, kjo po shihet edhe nga fotografia të cilën sot e dorëzoi avokati.

P.: Pyet dëshmitarin A., se a keni qenë tek mjeku lidhur me plagën që e keni marrë natën kritike?

Dësh.: Jo nuk kam qenë tek mjeku dhe nuk kam raport në lidhje me plagën e marrë.

Në pyetjen KTGJ.: Pas sa minutave kanë ardhur të tjerët?

Dëshmitari përgjigjet.: Pas 10 sekondave, një 40 metra janë larg Teqja prej Tyrbes .

Në pyetjen KTGJ.: Sa vet kanë dal?

Dëshmitari përgjigjet: 4 vetë kanë dal, 2 dhe B.M., pastaj kanë ardhur U. dhe A.

Në pyetjen KTGJ.: A ka bërë dikush, a ke dëgjuar ti?

Dëshmitari përgjigjet.: Jo nuk kam dëgjuar .

Në pyetjen KTGJ.: Sipas teje ku je lënduar?

Dëshmitari përgjigjet.: Në pjesën e majtë, poshtë dorës, kam qenë i goditur me shafsiger, me majën e shafsigerit më ka goditur. Një herë më ka goditur, e keqja ime është që nuk kam shkuar tek mjeku.

Gjykata nuk ia fal besimin kur dëshmitari deklaron se nuk ka tentuar me i ra askush të dëmtuarit, pasi që në bazë të incizimeve në CD-në e cila është pjesë e shkresave të lëndës, shihet se kur herën e parë është goditur këtu i dëmtuari A.A., kanë tentuar që ti bien prapë, por është penguar nga pjesëmarrësit tjerë, po ashtu kur thotë se të nesërmen kur kanë dal mi pastru gjakun, e kanë gjetur një thikë, pasi që në bazë të incizimit nuk shihet të ketë pas diçka tjetër këtu i dëmtuari, përveç kaqavidës dhe shufrës së hekurt.

PROVAT MATERIALE

Nga raporti i oficerit policor K.K.nr. PK..., datë 15.09.2018 konstatohet se me shkuarjen e vendit të ngjarjes së policisë kanë takuar personat të dyshimtë: i dyshuari 1# i cili kishte qenë i shtrirë për tokë dhe kishte lëndime në kokë, i cili është dërguar në ambulancë në emergjencë, i dyshuari #2 pasi kishte vërejtur se i dyshuari #1 kishte qenë duke sulmuar viktimën me një pajser dhe kaqavidë menjëherë ka reagu duke goditur me lopatë në kokë të dyshuarin pasi që ishte frikësuar se mos po lëndon shokun e tij.

Poashtu në këtë raport konstatohet se në orën 10:00/h nga Spitali Rajonal në Gjakovë me autoambulancë është transportuar, pas keqësimit të gjendjes shëndetësore të dyshuarit-dëmtuarit A.A. nën përcjellje të patrullës të stacionit policor Gjakovë në QKUK në Prishtinë në konsultim me prokurorin e shtetit.

Gjykata këtij raporti ia fal besimin meqenëse është lëshuar nga policia e Kosovës përkatësisht Stacioni policor në Gjakovë dhe me këtë raport vetëm ka përshkruar gjendjen në momentin e parë të arritjes në vendin e ngjarjes.

Është konstatuar se këtu i dëmtuari A.A. është qëlluar me lopatë, e cila është e njohur për gjykatën dhe prokurorinë dhe palët në procedurë nuk e kundërshtojnë faktin se këtu i dëmtuari është qëlluar me lopatën.

Në bazë të shikimi i CD-së nga vendi i ngjarjes konstatohet se me datën 15.09.2018, rreth orës 03:30/h, ku shihet këtu i dëmtuari se ka shkuar në Tyrben e B.D. dhe ka tentuar që të hynë në tyrbe, por në ato momente besimtarët të cilët ishin në objektin afër tyrbes, meqenëse ishte festa e Muharremit, i kanë dëgjuar zhurmat dhe kanë dalur nga objekti ku ishin duke qëndruar dhe janë drejtuar në drejtim të tyrbes, së pari A.Rr., të cilin këtu i dëmtuari A.A. e godet me kaçavidë në pjesën e poshtme të gjoksit, nën dorën e majtë, pastaj del edhe U.R. dhe nga pjesa e prapme e tyrbes del edhe i akuzuari A.B., i cili e godet me lopatë në pjesën e prapme të kokës këtu të dëmtuarin A.A..

Me ekspertizën mjeko-ligjore të Dr.B.C. e datës 30.10.2018, me të cilën pasi është kryer CT-ja e kokës, e cila ka rezultuar me një frakturë depresive të kafkës, pranimin e pacientit me vetëdije edhe pse ka deklaruar se ka pasur humbje të vetëdijes, të zgjeruara bebëzat izokorike, foto reaktive, nervat karnial, pa deficite, GCS-15 dhe pa shenja të lateralizimit, sistemet tjera janë pa veçori patologjike, indikohet interevenim kirurgjik urgjent, me anestezion të përgjithshëm, Dg:Fractura depressive parietalis sin.

Në bazë të kësaj që u tha më lartë, eksperti mjeko ligjor ka dhënë këtë mendim : Dëmtimet e përshkruara në pikën 1 të të gjeturave.

- Paraqet thyerje të kockës së tepës së kokës, majtas, me zhvendosje të fragmentit kockor, e cila është shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë të topitur dhe si e tillë, bënë pjesë **në dëmtim të rëndë trupor**.

Nga foto dokumentacioni shihet Tyrbja e B.D. në fshatin D., shihen shenjat e përdorimit të forcës në dritaren e tyrbes, shihet oborri përreth tyrbes, shihet thesi i zi plastik, ku stafi i emergjencës ka vendosur gjërat që i ka pasur i dyshimti, shihet tre telefona të tipit të vjetër, portofoli, shkresat dhe qesja e duhanit, shihet dritarja e tyrbes me hekurat për sigurimin e saj, shihet i dëmtuari A.A. i lënduar gjatë qëndrimit të tij në emergjencë, shihen parat metalike lek dhe euro, të cilat dyshohen se janë vjedhur tek ura e tabakëve, shihet lopata me të cilën është goditur i dëmtuari A.A., shihet kaqavida dhe shufra metalike me të cilat ka disponuar i dëmtuari.

Gjykata në bazë të këtyre fotove ka konstatuar se me datën 15.09.2018, në orën 02.30/h këtu i dëmtuari është gjendur në Tyrben e B.D. në fshatin D., duke tentuar që të hy brenda, duke e përdorur forcën, kaçavidë dhe shufrën e hekurit (shafsiger dhe pajserin).

Gjykata pas analizimit të të gjitha provave të proceduara, ka nxjerr këtë përfundim.

Se në veprimet e të akuzuarit A.B. në tërësi janë plotësuar të gjitha elementet esenciale të që përbëjnë veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3, lidhur me par. 1. nënpar.1.1. të KPRK-së, meqenëse me lëndimet e shkaktuara me veprim mekanik të mjetit të fortë të topitur, në rastin konkret ka shkaktuar lëndim të rëndë trupor gjë që vërtetohet nga ekspertiza mjeko-ligjore Dr. B.C., nga deponimet e dëshmitarit-dëmtuarit A.A., dëshmitarëve A.Rr. dhe U.R., ku konstatohet me saktësi se A.B. e ka qëlluar me lopatë të dëmtuarin në kokë dhe pasi që e ka qëllue me lopatë, i dëmtuari ka ra në tokë i alivanosur pa vetëdije dhe pastaj, dëshmitarët e kanë njoftuar policinë të cilin policia e dërgon në emergjencë dhe pas dhënies së

ndihmës së parë në emergjencë të njëjtin e dërgojnë për shërim të mëtutjeshëm në QKUK-në në Prishtinë

Në pikëpamje të dashjes të lëndimit të rëndë trupor kjo gjykatë konsideron se vet fakti i veprimit me lopatë dhe ramjes nga pas në kokë të jep me kuptu se i akuzuari ka patur dashje që ta lëndon në atë pjesë të trupit ku lëndimi ka qenë lëndim i rëndë dhe i rrezikshëm për jetë. Gjykata konstaton se shkaktar i lëndimit të rëndë në ditën kritike pasi që i dëmtuari shkon në tyrben e B.D. në D., ku ishin edhe besimtarët këtu dëshmitarët duke qëndruar në shtëpinë afër tyrbes duke festuar festën e muajit të M., ku në orën 02.:30/h këtu i dëmtuari shkon në tyrbe dhe tenton që të hyjë në tyrbe për të vjedhur, qëllimi i tij për të vjedhur është vërtetuar edhe nga CD-ja e cila është pjesë e shkresave të lëndës, dhe në këtë rast dëshmitarët e lartcekur së bashku me të akuzuarin e sulmojnë të dëmtuarin.

Gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike që u provua në shqyrtim gjyqësor gjeti se në veprimet e të akuzuarit A.B. përmbahen të gjitha elementet esenciale që e përbëjnë veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3, lidhur me par.1. nënpar.1.1. të KPRK-së, meqë lëndimet e shkaktuara kanë karakterin e lëndimit të rëndë trupor, po ashtu nga provat e proceduara u vërtetua me saktësi se dashja e të akuzuarit për shkaktim të lëndimit ekzistonte, me vet faktin se i akuzuari ka përdorur lopatën duke qëlluar të dëmtuarin pas në kokë, duke i shkaktuar thyerjen e kockës së tepës së kokës, majtas, zhvendosur fragmentin kockor dhe e kualifikuar si lëndim i rëndë trupor i rrezikshëm për jetë në momentin e shkaktimit.

Gjykata e gjykoi të akuzuarin A.B. për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3, lidhur me par. 1. nënpar.1.1. të KPRK-së, i përcaktoi dënim burgu në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, të shndërruar në dënim me gjobë në shumë prej tremijë euro (3.000,00) €.

Mbrojtja e të akuzuarit A.B.dhe tezat e mbrojtësit se i akuzuari nuk ka pas për qëllim të lëndojë dhe ti shkaktojë lëndime të rënda trupore të dëmtuarit por vetëm ta frikon.

Nga e gjithë kjo që është cekur, kjo gjykatë ka konstatuar se i akuzuari ka kryer veprën penale, me këtë rast ka kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3, lidhur me par. 1. nënpar.1.1. të KPRK-së, pasi që nuk ekzistojnë rrethanat të cilat përjashtojnë fajësinë e të akuzuarit, e ka shpallur fajtor.

Duke vendosur mbi dënimin, kjo gjykatë ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese nga të cilat varet lloji dhe lartësia sanksionit penalo - juridik përkatësisht dënimin për të akuzuarin A.B., si rrethanë lehtësuese mori moshën e tij relativisht të re, kohën kur ka ndodhur rasti, duke marrë parasysh se ka qenë ora 02.30/h pas mesnatës, pendimin e tij që ka kryer, se nuk e ka pas për qëllim që ta sulmojë apo ta lëndojë por qëllimi ka qenë që të parandalojë sulmin ndaj shokut të tij. Si rrethanë rënduese kjo gjykatë pati parasysh lëndimin që i është shkaktuar të dëmtuarit.

Duke pas për bazë rrethanat si me lartë, gjykata ka konkluduar që dënimi i shqiptuar është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale, lartësinë e pasojës së shkaktuar dhe intensitetit të lartë të rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, dhe se në këtë mënyrë do të arrihet qëllimi i dënimin dhe të bëhet ndikimi tek personat tjerë që të përmbahen nga veprimet kriminale si preventivë gjenerale, dhe se me këtë dënim do të arrihej qëllimi i dënimin paraparë me nenin 41 të KPK - së.

Duke u bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së, pala e dëmtuar udhëzohet që kërkesën pasurore juridike të realizoi në kontest civil.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marr bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR. nr. 68/18 datë 06.05.2019

Zyrtarja ligjore,
Arbënore Basha

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari,
Gëzim Pozhegu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.